



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:250630

Datë: 26.12.2024

Numri i dokumentit: 06655065

AC-I-24-0725

Në ankesën e

Paditësi/ankuesi

I D nga fshati T Prishtinë, të cilin e përfaqëson Avokati S A Prishtinë.

Kundër

E paditura

NSH, "Viktoria", (në likuidim), të cilën e përfaqëson, **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, Rr. 'Dritan Hoxha, nr. 55, Lakërishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj, dhe Asllan Krasniqi gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditësit të paraqitur kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-6131 të datës 15 gusht 2024, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 26 dhjetor 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e paditësit pjesërisht është e bazuar.**
- 2. Ndryshohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-6131 i datës 15 gusht 2024.**
- 3. Obligohet AKP-ja- Autoriteti i Likuidimit që ti paguaj paditësit në emër të pagave të pa paguara për muajin gusht dhe tetor 2011, si dhe për periudhën 2012-2013 shumën prej 1,272.40 euro,**

interesin ligjor prej 10 % të borxhit kryesor në shumë prej 127.24 euro, dhe shpenzimet e përfaqësimit nga ana e avokatit në shumë prej 208.00 euro, të gjitha shumat duhet të paguhen sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në Procedurën e Likuidimit.

4. Vërtetohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë i DHPGJS,C-IV-14-6131 i datës 15 gusht 2024 lidhur me pjesën e kërkesës për paga nga viti 2008 e deri më korrik 2011.

5. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me datë 15 shtator 2014, paditësi e dorëzoi në DHPGJS-ë një ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit PRN112-0004 të datës 22 korrik 2014, me të cilin i është refuzuar kërkesa e paditësit për paga të pa paguara për periudhën 2008/2013 nga NSH "Viktoria" (në likuidim) me arsyetimin se kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. Paditësi këtë vendim e kundërshton për të gjitha bazat ankimore duke pohuar se kërkesa nuk konsiderohet e parashkruar pasi që ai ka dorëzuar padi në DHPGJS me numër SCC-06-0450. Në ankesë ai paraqet zhvillimet procedurale që kanë ndodhë në këtë padi duke pohuar se lënda është kthyer në rigjykim pas aprovimit të revizionit nga Gjykata Supreme e Kosovës. Bashkë me këtë ankesë ai ka dorëzuar vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, Kopjen e padisë SCC-06-0450, e cila ka të bëjë me lirimin e NSH Viktoria e uzurpuar në mënyrë jo ligjore, kopjen e Aktvendimit të DHPGJS SCC-06-0450 datë 31 janar 2007 me të cilin padia e cekur është referuar në gjykatën Komunale në Prishtinë, regjistrin e punëtorëve për pagat e pa paguara për vitin 2012-2013, në të cilin regjistër paditësi është me numër rendor 13, si dhe regjistrin për pagat e pa paguara për periudhën 2008-2011, në të cilën paditësi është me numër rendor 13 dhe një shkresë –urgjencë drejtuar AKM-së.

Me datë 14 nëntor 2023, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS mbrojtjen në ankesë në të cilën AKP-ja ka pohuar se Autoriteti i Likuidimit ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar në mënyrë të drejtë kur është refuzuar kërkesa e paditësit. Tutje AKP-ja pohon se ankuesi ka dështuar tregojë se cili nen i Ligjit të AKP-së është shkelur nga ana e Autoritetit të Likuidimit,

duke pohuar se vendimi i ankimuar nuk është në kundërshtim me asnjë dispozitë ligjore. Tutje AKP-ja pretendon se paditësi nuk ka dorëzuar ndonjë provë para Autoritetit të Likuidimit për të dëshmuar se ai ka kërkuar pagat e pretenduara në afatin prej 3 viteve, andaj kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. AKP-ja i kundërshton pretendimet e paditësit edhe për pagat e pretenduara ndaj NSH-së. Nga këto arsye AKP-ja ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të vërtetohen vendimet e ankimuara të Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 15 gusht 2024, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-14-6131 ankesën e paditësit të paraqitur ndaj vendimit të Autoritetit të Likuidimit PRN112-004 të datës 15 maj 2014, e refuzon si të pa bazuar, e vërteton këtë vendim të Autoritetit të Likuidimit si të drejtë dhe të bazuar në ligj. Shkalla e I-rë ka arsyetuar se bazuar në neni 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar dhe të nenit 372 par.1 i LMD-së, kërkesa e paditësit për paga konsiderohet e parashkruar, pasi që ai ka dështuar të dorëzojë prova se e ka ndërprerë parashkrimin e kërkesës brenda tri viteve siç kërkojnë dispozitat e cekura ligjore. Shkalla e I-rë konstaton se pagat e vitit 2008 të kërkuara nga paditësi janë parashkruar në vitin 2011 ndërsa kërkesa tek Autoriteti i Likuidimit është dorëzuar me datë 26 mars 2014. Barra e provës bie mbi paditësin ai ka dështuar të sjell prova se e ka ndërprerë parashkrimin e kërkesës dhe ai këtë rast e ka pasur me urdhrin e lëshuar me datë 24 prill 2024.

Me datë 24 shtator 2024, paditësi e dorëzoi në DHPGJS një ankesë të afatshme kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-6131 të datës 15 gusht 2024, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkon nga Kolegji i Apelit të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar, të aprovohet ankesa e paditësit ndaj vendimit të Autoritetit të Likuidimit. Për më tepër në ankesë paditësi pohon se me Aktgjykimin e ankimuar nuk është vlerësuar në mënyrë të drejtë gjendja faktike, është zbatuar në mënyrë të gabuar e drejta materiale dhe nuk janë marrë në konsideratë argumentet ligjore dhe provat e dorëzuara në gjykatë. Në ankesë paditësi ka pohuar se Aktgjykimi i ankimuar është kontradiktor në mes të diapozitivit dhe arsyesimit të dhënë. Në ankesë ai i referohet zhvillimeve procedurale që kanë ndodhë lidhur me lëndën e tij në Gjykatën Komunale në Prishtinë e cila në bazë të Revizionit ishte kthyer në rigjykim dhe mban numrin Cnr.863/05. Ai pohon se të gjitha provat janë bashkangjitur ankesës të dorëzuar

me 2 shtator 2014 të cilat gjenden në shkresat e lëndës. Padiësi konsideron se është i gabuar konstatimi i Shkallës së I-rë të DHPGJS se kërkesa është parashkruar. Padiësi pretendon se me Aktgjykimin e ankimuar janë shkelur dispozitat e nenit 182.2 nënpika n) të LPK-së pasi që ky aktgjykim ka te meta nuk mund të ekzaminohet dhe është pa ndonjë mbështetje ligjore.

Me datë 22 tetor 2024, AKP-ja e dorëzon në DHPGJS një parashtresë dhe i përgjigjet ankesës së padiësës. Në këtë parashtresë AKP-ja e kundërshton ankesën e padiësës si të pabazuar dhe kërkon që të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së si i bazuar në ligj. Tutje AKP-ja ka pohuar se në mbrojtjen në padi ka sqaruar mjaftueshëm lidhur me argumentet e ngritura të ankesës dhe përsëritja e atyre argumenteve do të ishte e pa dobishme për mbarëvajtjen e procedurës. AKP-ja ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pabazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e padiësit pjesërisht është e bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i shkallës së I-rë të DHPGJS nuk është i saktë në rezultat dhe në arsyetim ligjor, lidhur me pjesën e kërkesës për paga nga periudha mars 2011- dhjetor 2013, dhe kërkesëpapia për pagat për këtë pjesë të periudhës aprovohet si e bazuar .

Kolegji i Apelit vëren se padiësi me datë 26 mars 2014 kishte dorëzuar një kërkesë për kompensim të pagave të papaguara për periudhën 2008-2013 në shumë të pa specifikuar.

Autoriteti i Likuidimit këtë kërkesë e ka refuzuar si të pavlefshme me arsyetimin se ajo është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Për të njëjtën bazë ligjore, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së e refuzon ankesën e paditësit për paga të pa paguara dhe e vërteton vendimin e ankimuar të Autoritetit të likuidimit, duke konstatuar se kërkesa është parashkruar.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me datë 26 mars 2014 e ka dorëzuar tek Autoriteti i Likuidimit për kërkesën e tij për paga. Në bazë të këtij fakti del që pagat nga muaji mars 2011 e deri në dhjetor 2013, nuk mund të konsiderohen të parashkruara siç konsideron gabimisht Autoriteti i Likuidimit dhe Shkalla e I-rë e DHPGJS-së pasi që nuk kanë kaluar tri vite të afatit të parashkrimit. Pagat tjera të periudhës së më hershme nga viti 2008 e deri shkurt 2011 janë parashkruar.

Padia në të cilën thirret paditësi të dorëzuar në DHPGJS e evidentuar SCC-06-0450 nuk e ka ndërprerë parashkrimin e kërkesës për paga, për faktin se kjo padi është e një natyre tjetër me të cilën kërkohet lirimi i NSH-së Viktoria pohuar se është uzurpuar në mënyrë jo ligjore, e nuk është padi për paga, dhe po ashtu kjo padi nuk është paraqitur nga paditësi I D, por është padi e nënshkruar nga Drejtori i NSH R G.

Paditësi me ankesën e tij ka dorëzuar Listat e pagave të pa paguara për vitin 2008-2011 dhe për vitin 2012-2013. Në këtë listë është edhe paditësi me numër rendor 13.

Në bazë të listës së pagave të pa paguara të periudhës 2008-2011 për periudhën që ende nuk është parashkruar kërkesa për paga, vërehet se paditësi ka të drejtë në paga vetëm për muajin gusht 2011 në shumë prej 127.42 euro, dhe muajin tetor 2011 në shumë prej 127.42 euro. Në këtë Listë nuk ka borxh të NSH-së për muajit tjerë që nuk janë parashkruar.

Tutje në bazë të Listës së pagave të pa paguara për vitet 2012-2013, borxhi i NSH-së për paga ndaj paditësit është në shumë prej 1,017.56 euro.

Andaj bazuar në këto dy prova kalkulimi i borxhit në emër të pagave të pa paguara, është bërë në bazë të dy listave dhe atë borxhi për muajin gusht dhe tetor 2011

është në shumë prej 254.84 euro, dhe borxhi për periudhën 2012-2013 në shumë prej 1,017.56 euro, dhe të gjitha në shumë prej 1,272.40 euro.

Kjo shumë borxhit të pa paguar dhe interesi ligjor prej 10 % bazuar në nenin 37.3 të Shtojcës së ligjit të AKP-së do të paguhet sipas prioriteteve të përcaktuar me ligj në procedurën e likuidimit.

Bazuar në nenin 62.2 të LDHP-së, AKP-ja duhet ti paguaj paditësit edhe shpenzimet e përfaqësimit nga ana e avokatit në shumë prej 208 euro, sipas prioriteteve të përcaktuar me ligj në procedurën e likuidimit.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore

Ankuesi tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore në shumë prej 20 euro, me datë 31 tetor 2024, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 26 dhjetor 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues
